



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Zenun Elezaj, Kryetar i Komunës së Klinës Fadil Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Klinës	
CC:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave -MAPL	
Përmes:	Adrijana Hodžić, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Xhevat Tafa, U.D. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave, MAPL	Datë: 13/06/2019 020-676
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë e aktit të komunës së Klinës	
Lloji i aktit:	Vendim i kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e QRK-së Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësit Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr.060-22310/2019 për miratimin e Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Klinës 2019-2023
I miratuar më datë më datë: 31.05.2019
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 10.06.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



ZA:	Zenun Elezaj, gradonačelnik Opštine Klina	
Kopija:	Fadil Gashi, predsedavajući Skupštine opštine Klina Jedinica za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinica za administraciju dokumenata u opštini Pravno odeljenje i monitorisaje opština	
Preko:	Adrijana Hodžić, ministarka MALS-a, Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka u MALS-u, <i>pr: Adrijana Hodžić</i>	
Od:	Xhevat tafa, v.d. rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština - MALS	Datum, 13.06.2018.
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Klina	Br. 020-676
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine	

Uvaženi gradonačelnice,
Uvaženi predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 04/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka Skupštine opštine 01br.060-22310/2019 za usvajanje Akcionog plana za transparentnost u opštini Klina za period 2019-2023
Usvojena dana, 13.06.2019. godine
Predložena za razmatranje u MALS-u dana, 10.06.2019. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je **isti sa proceduralnog aspekta u saglasnosti sa zakonskim odrebama zakonodavstva na snazi** i kao takav može proizvesti pravni učinak.

Ministarsvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Në bazë të nenit 12.1 dhe 12.2 pika d) të nenit 68 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenit 15 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Për Transparencë në Komuna Nr. 04/2018 dhe dispozitave të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.06/2018 Për Standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, dhe Rregullores (MAPL) nr.06/2018 në Komunën e Klinës si dhe rekomandimet e MAPL- nr.020-120/6 të dt.27.02.2019-për Rishqyrtim të Planit të Veprimit, Kuvendi i Komunës së Klinës, në seancën e V- të, të rregullt, të mbajtur më datën 31/05/2019, miratoi këtë:

VENDIM

**Për
Miratim të Planit të Veprimit Për Transparencë në Komunën e
Klinës 2019-2023**

HYRENI-LIAPNA INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO
SEKRETARATI I KOMUNËS KLINA LOCAL GOVERNMENT OF KLINA

Miratoimi e Administrimit të Peshitetit Lokal
Impletstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Municipality of Local Government Administration

10.06.2019

Adresa e Komunikimit Nr. i Lëvizjes	Shtetësi	Vlera
-VI- 020-676		

I

Miratohet Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Klinës për periudhën 2019-2023.

II

Plani si në pikën I të këtij vendimi ka synim që t'i ofroj publikut qasje në pjesëmarrje në takimet e hapura të komunës dhe kuvendit të komunës si dhe publikimin e akteve të komunës. Gjithashtu bashkëpunimin me shoqëritë civile, dhe kategoritë e veçanta për të qenë sa ma transparent në menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, prokurimit dhe sferave tjera të cilat janë në interes për publikun.

III

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Klinës për periudhën 2019-2023.

IV

Vendimi është i plotfuqishëm që nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës dhe 15 ditë pas protokollimit në MAPL në bazë të nenit 81 të LVL dhe nenit 16 dhe 17 të Rregullores së MAPL Nr.01/2017.

V

Me këtë vendim njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Zyra për Informim, Zyra Ligjore, Një kopje për Shërbimin për punë të Kuvendit dhe një Kopje për Arkivin e Komunës së Klinës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01N/ 060-2230 /2019
Klinë, me 06.06 2019





Na osnovi clana 12.1 i 12.2 tacka d), clana 68 Zakona 03/L-040 ("Sluzbeni List Republike Kosova", br. 28/2008), clana 15 Administrative Upustva MALS o Transparentnosti u Opstinama Br. 04/2018 i odredaba AU MALS br.06/2018 o Minimalnim Standardima savetovanja sa javnoscu u opstinama i Ostinske Uredbe o Transparentnosti u Opstini Klina i preporuka MALS broj 020-120/6 dana 27.02.2019- o pregledu Plana Akcije, Skupstina Opstine Klina u svojoj V-oj redovnoj sednici za 2019 godinu, dana 31/05/2019, uzima sledecu:

Ministry of Local Government Administration			
Date: 10.06.2019			
Administrative Unit	City	Street	Post
10-1020-676			

ODLUKU

o

Planu Akcije za Transparentnost u Opstini Klina za 2019-2023 period

I

Usvaja se Akcioni Plan za Transparentnost u Opstini Klina za period 2019-2023.

II

Plan kao po tacku 1 ove odluke ima za cilj da javnoscu pruza pristup u otvorenim sastancima Opstine i Skupstine Opstine kao i u objavljivanju opštinskih akata.

Takodje, plan ima za cilj i saradnju sa civilnom društvom i posebnim ostalim kategorijama kako bi imali sto vecu transparentnost u upravljanju javnih finansija i odgovornosti, nabavke i ostalim poljima koje su u interes gradjana.

III

Sastavni deo ove odluke je i Plan Akcije Transparentnosti u Opstini Kina za period 2019-2023.

IV

Odluka je punovazna po usvajanju u Skupštini Opstine i 15 dana posle protokolisanja u MALS na osnovi clana 81 ZLS kao i clana 16 i 17 Uredbe MALS broj 01/2017.

V

Obavestavaju se: MALS, Predsednik Opstine, Kancelarija za Informisanje, Pravna Kancelarija, Sluzba Opstine i Arhiva Opstine.

SKUPSTINA OPSTINE KLINA

01br/ 060-22910 /2019
Klina, 06.06. 2019



Predsedavajući,
Fadil Gashi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

REPUBLIKA E KOSOVËS | REPUBLIC OF KOSOVO | REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E KLINË
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA
Nr. No. Br. 060-27310/19
Data-Date-Datum: 06.06.2019
Klinë, Klina

**PLANI I VEPRIMIT
PËR TRANSPARENCË NË KOMUNË
2019-2023**

Klinë, Maj 2019

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 dhe 12.2, pika d, të Ligjit, për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), nenit 15 Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.04/2018 për Transparencë në Komuna, dispozitave të Udhëzimit Administrativ nr.06/2018 (MAPL) për Standardet minimale të konsultimit publik në komuna, nenit 13 të Rregullores për Transparencë në Komunën e Klinës, nr.01-031-5713/2014 të miratuar me 26.12.2014, nenit 10 paragrafi 4 të Statutit të Komunës së Klinës, nr.01-110-1232/2010 të miratuar me 31.03.2010 dhe legjislacionit tjetër në fuqi, Kryetari i Komunës së Klinës, i propozon Kuvendit të Komunës së Klinës këtë Plan të Veprimit për Transparencë në Komunën e Klinës për periudhën katër (4) vjeçare, i cili përmban këto objektiva:

Hyrje

Komuna e Klinës, do të ndër marrë të gjitha veprimet dhe mjetet e nevojshme në funksion të jetësimit të këtij dokumenti në plotninë e tij, me synim që, komuna jonë të jetë e të gjithëve dhe për të gjithë, duke u bashkërenduar me kryetarin, ekzekutivin, kryesuesin dhe akterët tjerë relevant brenda dhe jashtë komunë për vendimmarrje të hapur, konsultative, transparente, të përgjegjshme e llogaridhënëse:

Objektivat e Panit të Veprimit

Mbledhjet e rregullta, të jashtëzakonshme, solemne të Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve tjera, do të jenë të hapura për të gjithë. Në këtë objektiv parashikohet:

Njoftimi për mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës dhe komiteteve përmes faqes zyrtare, rrjeteve sociale, mediave të shkruara dhe elektronike për vendin dhe kohën e mbajtjes së mbledhjes me agjendë pune.

Aktiviteti i njoftimit bëhet nga sekretaria e Kuvendit dhe njoftohet zyra për komunikim me publikun, për të publikuar njoftimin, së paku shtatë (7) ditë përpara mbajtjes së mbledhjes.

Mbledhjet e Kuvendit do të përcillen online përmes faqes zyrtare të Komunës dhe teleprezencës për monitorim nga Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal dhe transmetohen drejtpërdrejtë në Radio lokale. (të kontraktuara nga komuna)

Kryesuesi i Kuvendit njofton Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal shtatë (7) ditë pune para mbledhjes së rregullt të Kuvendit.

Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës.

Njoftimi për mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës bëhet përmes ueb-faqes zyrtare, medieve të shkruara/elektronike, rrjeteve sociale, etj... mbi vendin e mbajtjes së mbledhjes, datën, orën dhe rendin e ditës.

Njoftimi bëhet nga sekretaria e Kuvendit dhe njoftohet ZKP-ë, për të publikuar njoftimin së paku tre (3) ditë para mbajtjes së mbledhjes.

Mbledhjet e jashtëzakonshme do të përcillen online përmes faqes zyrtare të Komunës dhe teleprezencës për monitorim nga Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal dhe transmetohen drejtpërdrejtë në Radio lokale dhe rrjeteve sociale të Komunës së Klinës.

Kryesuesi i Kuvendit njofton Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal tre (3) ditë pune para mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit.

Konsultime me publikun para miratimit të aktit,

Komuna e Klinës organizon diskutime publike me qytetar para miratimit të aktit nga Kuvendi e që janë me interes për qytetaret.

Rekomandimet e paraqitura nga ana e qytetarëve shqyrtohen nga ekspertet e çështjeve të caktuara, pastaj ato rekomandime përfshihen në aktin, i cili i dërgohet Kuvendit për miratim.

Konsultimet para miratimit të aktit behën :

Konsultime për buxhet,

Konsultime për zhvillim ekonomik lokal,

Konsultime për planifikim hapësinor,

Konsultime për investime,

Konsultime për të hyra komunale dhe

Konsultime për çështje tjera në interes të përgjithshëm.

Aktiviteti i njoftimit bëhet nga projekt propozuesi dhe njoftohet ZKP-ë, paku dy (2) javë para mbajtjes së konsultimeve me publikun dhe publikohet në ueb-faqe zyrtare të komunës, në media të shkruara dhe elektronike, në rrjete sociale si dhe në vendet e frekuentuara.

Takimet me publikun, parashikohet:

Komuna, përkatësisht Kryetari i Komunës, do të mbajë së paku dy (2) takime me publikun gjatë vitit (njëri në fund të gjashtëmujorit të parë dhe tjetri në fund të vitit fiskal), për çështje të interesit të përgjithshëm, në të cilin takim mund të marrë pjesë secili person apo organizatë me interes në Komunë

Përveç këtyre dy takimeve me qytetarë, Komuna mund të mbajë edhe takime tjera me publikun që do të shqyrtohen objektivat e parapara në pikën tre (3) të këtij Plan Veprimi.

Aktiviteti i njoftimit bëhet nga kabineti i Zyrës së Kryetarit, përkatësisht nga ZKP-ë, së paku dy javë përpara mbajtjes së takimit me publikun dhe publikohet në ueb-faqe zyrtare të Komunës, në medie, vende të frekuentuara si dhe në rrjete sociale.

Takimet dhe intervistat e Kryetarit të Komunës me qytetarë, OJQ-ë dhe gazetarë.

Takime në formë debati me qytetarë,

Takime pyetje dhe përgjigje,

Intervista, komunikata, konferenca për media dhe

Kryetari mban takime me qytetarë, përfaqësues të OJQ-ve dhe gazetarë, sipas kërkesave të adresuara nga ana e tyre. Çdo kërkesë e adresuar shqyrtohet nga ana e kabinetit të kryetarit dhe më pas caktohet orari i takimit.

Në rast të takimeve në formë të debatit, aktiviteti i njoftimit bëhet nga kabineti i kryetarit dy javë para, përmes ZKP-së, për njoftimin e agjendës dhe vendin e mbajtjes së takimeve.

Qasjes në Dokumente Publike.

Për të qenë sa më transparent ndaj qytetarëve, Komuna e Klinës në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Klinës, në menynë "Qasja në Dokumentet Publike", i ka të publikuara informatat e personave kontaktues për qasje në dokumente zyrtare. Secili qytetar ka të drejtë të bëjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare. Njësia/zyra për Komunikim bënë pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumente publike dhe i adreson ato tek njësia ku gjendet dokumenti/informatat, dhe pas marrjes së dokumenteve/informatës, në pajtueshmëri me Ligjin Nr.03/L-2015 për Qasje në Dokumente Publike e dërgon të kërkuesi.

Shqyrtimi i kërkesave për informim, iniciativat qytetare dhe peticionet.

Kërkesat për informim, nismat qytetare dhe peticionet do të trajtohen drejtpërdrejtë apo përmes kërkesave me shkrim.

Kërkesat për informim, nismat qytetare dhe peticionet do të shqyrtohen nga Kuvendi i Komunës, brenda afatit prej 60 ditësh.

Aktiviteti i njoftimit bëhet nga zyra për shërbime profesionale e Kuvendit dhe i përcjellët ZKP-së, për publikimin e njoftimit.

Publikimin e akteve komunale.

Të gjitha Rregulloret, Vendimet dhe dokumentet tjera të Kuvendit të Komunës, publikimi i të cilit nuk kufizohet sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, bëhet publike dhe të qasshme për publikun pas vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL.

Të gjitha këto akte nënligjore dhe dokumentet tjera publikohen në ueb faqen zyrtare të Komunës, pas pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas regjistrimit në MAPL, ndërsa dokumentet tjera pas hyrjes në fuqi.

Aktiviteti i njoftimit bëhet nga Sekretaria e Kuvendit, ndërsa publikimi i dokumenteve në nga Zyra për Komunikim me Publikun.

Freskimin e faqes zyrtare të Komunës.

Ueb-faqja zyrtare e Komunës së Klinës, plotësohet çdo ditë me informata, sipas Udhëzimit administrative (MAP) Nr.01/2015 për ueb-faqete institucioneve publike. Këto informata përfshijnë: lajme rreth aktiviteteve ditore, njoftime për takime publike, konkurse, projekte kapitale, raporte financiare, informata të drejtorive, udhëzues për qytetarë etj.

Shërbime komunale, transparente dhe të shpejtë.

Lëshimi e certifikatave dhe ekstrakteve të lindjes, certifikata të vdekjes, certifikata të martesës, certifikata të statusit martesor, dëshmi që personi është gjallë, dëshmi për vdekje, regjistrimi i lindjeve, regjistrimi i vdekjeve etj.

Të gjithë formularët për ofrimin e shërbimeve të qytetarëve sipas pikës 10.1 duhet të publikohen në ueb-faqen zyrtare ku qytetari të ketë qasje dhe informata për realizimin e të drejtës së tij.

Zyra e Gjendjes Civile është njësi prodhuese e tyre dhe furnizuese për palën kërkuese. Ndërsa për publikimin e formularëve është përgjegjëse zyra e IT-së.

Prokurimin transparent.

Komuna në afat kohor duhet ti publikoj:

- 1 Planin e prokurimit,
- 2 Raportin për kontratat e nënshkuara sipas viteve,
- 3 Njoftimet për kontrata,
- 4 Njoftimet për dhënien e kontratave,
- 5 Njoftimet për konkurs të projektimit,
- 6 Njoftimet për anulim,
- 7 Njoftimet për informata shtesë,
- 8 Njoftimet për nënshkrimin e kontratës dhe
- 9 Njoftimet për anulimin e dhënies së kontratës.

Procedurat e punësimit transparent për qytetarë.

Shpallja e konkurseve,

Njoftimi për përzgjedhjen e kandidatëve,

Njoftimi për anulimin e konkursit,

Rishpallja, apo vazhdimi i konkursit,

Avancimet brenda institucionit,

Përgjegjës për kompletimin e procedurave të rekrutimit të shërbimit civil është Zyra e Personelit, ndërsa për publikimin e tyre Zyra e Komunikimit me Publikun.

Publikimi i të gjitha procedurave në shërbimin civil publikohen në ueb-faqe zyrtare të komunës, në objektin e Komunës, në media të shkruara dhe atyre elektronike. Publikimi duhet të jetë edhe te institucionet përgjegjëse për shërbimin civil.

Rritja e bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe qytetarët për hartimin e akteve në Komunë. Për të përmbushur këtë objektiv, plani i veprimit parashikon ndër të tjera:

Ngritjen e vetëdijes për mbrojtjen e të drejtave të kategorive të veçanta si fëmijët, gratë, personat me aftësi të kufizuara etj., të cilët në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët socialë do të kenë në qendër të vëmendjes problematikat e këtyre grupeve.

Organizimin e takimeve me shoqërinë civile për rritjen e bashkëpunimit për të evidentuar rrugët dhe mënyrat e bashkëpunimit.

Përmirësime sipas nevojës në Rregulloren e Kuvendit për afatet e konsultimit të projekt-akteve me organizatat e shoqërisë civile dhe caktimin e rregullave shtesë për bashkëpunimin dhe qasjen e organizatave të shoqërisë civile në punimet e Kuvendit të Komunës.

Ndihma tjera për organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët socialë.

Publikimi i projekt-akteve në faqen e internetit.

Forcimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit të Komunës.

Zbatimi i dispozitave ligjore dhe akteve tjera që mundësojnë kontrollin e Kuvendit ndaj Ekzekutivit lidhur me zbatimin e politikave dhe buxhetin vjetor komunal.

Caktimi i pikave të veçanta në seanca të KK-së, për pyetje drejtuar ekzekutivit për çështje të caktuara me interes publik.

Përfshirja e raporteve të ndryshme të institucioneve dhe organizatave që lidhen me planin e veprimit të punës së Kuvendit.

Forcimi i kapaciteteve administrative të Kuvendit dhe Komunës si tërësi.

Parashikimin e një buxheti të veçantë për trajnimin e administratës.

Rritjen e kapaciteteve për shërbimin e teknologjisë së informacionit.

Sigurimin e buxhetit nga donacionet për kompensimin e një numri të caktuar të stafit këshillëdhënës për Kryetarin e Komunës, Kryesuesin e KK-së etj.

Numeracion dhe platformat e tjera për t'i dhënë qytetarëve informata lidhur me shërbimet që i ofron Komuna.

Përmes numrit, 038 20043716, si dhe numrit +383 49920517 në Viber dhe WhatsApp, qytetarët kanë mundësi t'i paraqesin kërkesat apo ankesat e tyre me qëllim të identifikimit të problemeve apo marrjes së informatave të ndryshme për shërbimet që ofron Komuna.

Po ashtu qytetarët kanë mundësi që edhe nëpërmjet platformës ndreqe.com, t'i shkruajnë dhe adresojnë problemet e ndryshme në komunë.

Secila drejtori e Komunës dhe njësitë kryesore të Komunës, i kanë të publikuar në web faqen zyrtare të Komunës numrin e telefonit dhe e-mailin zyrtar të tyre, duke i dhënë qytetarëve mundësi të lehtë për t'i kontaktuar me qëllim të adresimit të pyetjeve apo ankesave të tyre.

Plani i Transparencës Komunale është për katër (4) vite, sipas Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.04/2018, i njëjti mund të ndryshohet dhe plotësohet sipas nevojës.

Objektivat e Planit të Veprimit për Transparencë në Komunë / 2019-2023

	Objektivat e planit të veprimit të transparencës	Aktivitetet e planit të transparencës	Njësia / apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteteve të komunës	Vendi mbajtjes të aktiviteteve	Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteteve të organeve komunale
1	Mbledhjet e rregullta të kuvendit Komunal dhe të Komiteteve të tjera	Njoftimi për mbledhje të rregullta të Kuvendit Komunal dhe komiteteve bëhet në: Ueb faqe zyrtare, në media të shkruar dhe elektronike, në rrjete sociale	Sekretaria e Kuvendit përmes Njesisë/Zyrës për Komunikim me Publikun, njofton qytetarët së paku 7 ditë përpara mbajtjes së mbledhjes	Salla e Kuvendit Komunal	Njoftimi për mbledhjet e rregullta të Kuvendit Komunal është 7 ditë para mbajtjes.
2	Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal	Njoftimi për mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal bëhet në: Ueb faqe zyrtare, në media të shkruar dhe elektronike, hapësira administrative të Komunës, në rrjete sociale	Sekretaria e Kuvendit përmes Njesisë/Zyrës për Komunikim me Publikun, bënë njoftimin për mbledhje.	Salla e Kuvendit Komunal	Njoftimi për mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal është 3 ditë para mbledhjes.
3	Konsultimet me publikun	Komuna organizon Konsultime të ndryshme që janë me interes për qytetarë: Konsultimet për buxhet dhe dëgjime për planifikim buxhetor, konsultimet për zhvillimin ekonomik lokal, konsultimet për investimet dhe konsultimet për çështje të tjera në interes të përgjithshëm.	Sekretaria e Kryetarit përmes Njesisë/Zyrës për Komunikim me Publikun, njofton qytetarët së paku dy javë përpara mbajtjes së takimit publik. Njoftimi bëhet në ueb faqe zyrtare, në media të shkruar dhe elektronike, në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës dhe në rrjete sociale.	Në sallë e Kuvendit Komunal, ose në objekte me hapësira të mjaftueshme brenda territorit të komunës për pjesëmarrje të gjerë dhe aktive të publikut.	Njoftim për konsultime me publikun, publikohen dy javë para seancës së konsultimeve.

4	Takimet me publikun	Komuna mban së paku dy takime publike për çështje të interesit të përgjithshëm, në të cilën mund të marr pjesë secili person apo organizatë me interes në Komunë. Përveç dy takimeve publike, Komuna dhe Kuvendi mund të shqyrtoj mundësin për të mbajtur takime shtesë, dhe që lidhen me buxhetin komunal, zhvillimin ekonomik lokal, përdorimin e pronës komunale, planifikimin hapësinor, investimet, të hyrat komunale si dhe çështje të tjera në interes të përgjithshëm.	Njoftimi për mbajtjen e takimeve bëhet nga ZKP-ë, e cila njofton qytetarët së paku dy javë përpara mbajtjes së takimit publik. Njoftimi bëhet: Në ueb faqe zyrtare, në media të shkruar dhe elektronike, në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës dhe në rrejte sociale	Në sallën e Kuvendit të Komunës, ose në ndonjë vend brenda territorit të Komunës me pjesëmarrje të gjerë dhe aktive të publikut.	Njoftim për takimet me publikun publikohen dy javë para mbledhjes së konsultimeve.
5	Takimet dhe Intervistat e Kryetarit të Komunës me qytetarë, OJQ-ë dhe gazetarë	Varësisht nga kërkesat e qytetarëve, Kryetari i Komunës në kuadër të kompetencave të tij duhet të realizojë takime në formë të debatit, takime me pyetje dhe përgjigje, intervista, komunikata etj.	Kabineti i kryetarit përmes ZKP-së, bënë njoftimin para mbajtjes së takimit dhe e publikon në ueb faqe, në rrjete sociale, në media të shkruara dhe elektronike.	Në sallë e Kuvendit Komunal, në sallën e mbledhjeve ose në objekte me hapësira të mjaftueshme.	Njoftimi për qytetarët lidhur me takimet dhe intervista me kryetarin e komunës duhet të bëhet dy javë para takimit apo intervistes, në raste të veçanta edhe brenda ditës.

6	<p>Qasjes në Dokumente Publike</p>	<p>Kërkesat për qasje në dokumente trajtohen nga cilido institucion publik që posedon dokumentin e mbikëqyrë informatën. Institucioni publik (Komuna) ndihmon kërkuesin, aq sa është e mundshme në bazë të arsyeshmërisë, të identifikojë dokumentin e kërkuar. Kërkesat për qasje në dokumente publike trajtohen në mënyrë të barabartë.</p>	<p>Për të qenë sa më transparent ndaj qytetarëve, Komuna e Klinës në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Klinës, në menynë "Qasja në Dokumentet Publike", i ka të publikuara informatat e personave kontaktues për qasje në dokumente zyrtare. Secili qytetar ka të drejtë të bëjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare. Njësia/zyra për Komunikim bënë pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumente publike dhe i adreson ato tek njësia ku gjendet dokumenti/informatat, dhe pas marrjes së dokumenteve/informatës, në pajtueshmëri me Ligjin Nr.03/L-2015 për Qasje në Dokumente Publike e dërgon të kërkuesi.</p>	<p>Kërkesat për qasje në dokumente publike mund të parashtrihen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo përmes kërkesës me shkrim ose në formë elektronike.</p>	<p>Organet e Komunës (njësia që posedon dokumentin) obligohet që brenda shtatë (7) ditësh nga dita e pranimin të kërkesës të kthejë përgjigje njësisë kërkuese, ndërsa për të arsyetuar refuzimin e plotë apo të pjesshëm njofton kërkuesin me shkrim dhe informon kërkuesin për të drejtën e tij të ankesës. Afati për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente mund të vazhdohet sipas Ligjit për Qasje.</p>
7	<p>Kërkesat për informim, iniciativat qytetare dhe petitionet</p>	<p>Subjekti fizik ose juridik ka të drejtë të parashtror kërkesë për realizimin e ndonjë të drejte iniciative qytetare dhe</p>	<p>Pas diskutimit në Kuvendin e Komunës, Kryetari i Komunës ose</p>	<p>Kërkesë për informim, iniciativat qytetare dhe petitioni</p>	<p>Kërkesat, iniciativat qytetare dhe petitionet shqyrtohen nga Kuvendi i Komunës</p>

	<p>peticion, për çeshtje që janë përgjegjes organet e Komunës.</p> <p>Investimet në interes të përgjithshëm, ku participimi është bashkë me qytetarët.</p> <p>Mbështetje OJQ-ve për realizimin e aktiviteteve në interes të përgjithshëm.</p>	<p>Zyra për Komunikim me Publikun, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e shqyrtimit njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose peticionit.</p>	<p>parashtrohen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo përmes kërkesës me shkrim.</p>	<p>brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh siç është e përcaktuar në nenin 70 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.</p>	
8	<p>Publikimi i akteve komunale</p>	<p>Të gjitha vendimet, rregulloret dhe dokumentet tjera të Kuvendit të Komunës, publikimi i të cilave nuk kufizohet sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, bëhen publike dhe të qasshme për publikun pas vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.</p>	<p>Zyra për Komunikim me Publikun, përmes njësive që posedojnë dokumentacione t për publikim.</p>	<p>Të gjitha aktet nënligjore dhe dokumenteve tjera publike duhet të publikohen në ueb faqe të Komunës, media të shkruara dhe elektronike, apo në rrjete sociale.</p>	<p>Aktet nënligjore të komunave publikohen në faqe zyrtare 15 ditë pas regjistrimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, ndërsa dokumentet tjera publike publikohen pas hyrjes në fuqi.</p>
9	<p>Freskimi i ueb faqes zyrtare të Komunës</p>	<p>Ueb-faqja zyrtare e Komunës bëhet sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2015 për ueb faqet e Institucioneve Publike.</p>	<p>Obligohen Zyra për Komunikim me Publikun dhe e IT-së që të ndermarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij Udhëzimi Administrativ dhe përditësimin e saj sipas aktiviteteve që realizon komuna.</p>	<p>Ueb-faqja e komunës gjithashtu duhet të ketë Hartën e faqes, lidhja (linku) me portalin shtetëror dhe ueb faqet e institucioneve vartëse dhe lidhjen (linkun) me Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe Jincëve të tjera që janë në interes të përgjithshëm.</p>	<p>Mirëmbajtja ueb-faqen zyrtare duhet të jetë funksionale ashtu siç e përcakton Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2015.</p>

10

Qasja e qytetarëve në shërbime komunale duhet të jetë mënyrë transparente dhe e shpejtë

Certifikata të lindjes, certifikata të vdekjes, certifikata të martesës, certifikata të statusit martesor, dëshmi për personin që është gjallë, dëshmi për vdekjen, e cila u shërben qytetarëve për trashëgimi, vërtetimin që është mbajtur i familjes, regjistrimi i lindjeve, regjistrimi i vdekjeve, regjistrimi i kurorëzimeve nga bota e jashtme për të gjitha komunat e Kosovës, si dhe certifikatat mbi bashkësitë familjare.

Zyra e Gjendjes Civile është njësi prodhuese e tyre dhe furnizuese për palën kërkuese. Ndërsa për publikimin e formularëve është përgjegjëse zyra e IT-së dhe ZKP-ë.

Formularët për orrimin e shërbimeve të qytetarëve duhet publikuar në ueb faqen zyrtare, ku qytetari ta ketë qasjen e lehtë.

Në ueb faqe zyrtare të linku i shërbimeve për qytetarët, publikohen edhe procedura për shërbime dhe afate e caktuar për kryerjen e shërbimeve.

11

Prokurimi
Transparent

Planin e prokurimit,
Raportin për kontratat e nënshkruara sipas viteve,
Njoftimet për kontrata,
Njoftimet për dhënie e kontratave,
Njoftimet për konkurs të projektimit,
Njoftimet për anulim,
Njoftimet për informata shtesë.

Përgjegjëse për përgatitjen e dokumenteve është Zyra e Prokurimit, e cila i dërgon këto njoftime për publikim në E-prokurim, përkatësisht në KRPP dhe në ZKP-ë.

Njoftimet nga tusha e prokurimit bëhen në ueb e KRPP-së dhe në ueb faqen e Komunës së Klinës, tek linku i Prokurimit.

Të gjitha njoftimet e prokurimit bëhen publike sipas afateve ligjore në fushat e prokurimit.

		<p>I Njoftimet për nënshkrimin e kontratës dhe</p> <p>I Njoftimet për anulimin e dhenies së kontratës</p>			
12	Procedurat e punësimit transparente për qytetarët	Shpallja e konkurseve, njoftimi për përzgjedhjen e kandidatëve, njoftimi për anulimin e konkursit, rishpallja, apo vazhdimi i konkursit, avancimet brenda institucionit.	Përgjegjës për kompletimin e procedurave të rekrutimit të shërbimit civil është Zyra e Personelit, ndërsa për publikimin e tyre është Zyra për Komunikim me Publikun.	Publikimi i procedurave në shërbimin civil publikohen në ueb faqe zyrtare të Komunës, rrjetet sociale dhe në tabelën para objektit të Komunës.	Publikimi dhe zbatimi i procedurave të shërbimit civil bëhet në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil. Afatet shpalljen konkursit, njoftimit të kandidatëve, vazhdimi i konkurseve etj.
13	Rritja e bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe qytetarët gjatë hartimit të akteve në Komunë	Ngritja e vetëdijes për mbrojtjen e të drejtave të kategorive të veçanta si: femiljet, grate, personat me aftësi të kufizuara etj. Organizimin e takimeve me shoqërinë civile për rritjen e bashkëpunimit për të evidentuar rrugat dhe mënyrat e bashkëpunimit. Përmirësimi sipas nevojës në Rregulloren e Kuvendit për afatet e konsultimit të projekt-akteve me organizatat e shoqërisë civile dhe caktimin e rregullave shtesë.	Komuna harton propozime për Kuvend, ndërsa kjo e fundit miraton aktet që kanë të bëjnë në përmirësimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile, kurse ZKP-ë publikon aktet dhe dokumentet që nxirren nga Komuna dhe Kuvendi.	Publikimi i projekt-akteve bëhet në ueb faqen zyrtare të Komunës.	Publikimi i akteve të miratuara nga Komuna dhe Kuvendi publikohen pas shqyrtimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja (vetëm ato që duhet të shqyrtohen për ligjshmeri nga MAPL-ja).
14	Forcimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit të Komunës	Zbatimi i dispozitave ligjore dhe akteve tjera që mundësojnë kontrollin e Kuvendit ndaj	Komuna (ekzekutivi) propozon Kuvendit pika të	Propozimet mund të dalin nga mbledhja e kolegjiut të	Pas caktimit të sugjerimeve, ato dërgohen në Komitetin për

		Ekzekutivit lidhur me zbatimin e politikave dhe buxhetit vjetor komunal.	çaktuara që janë në interes të përgjithshëm.	ekzekutivit, dhe ju dërgohen Sekretarisë së Kuvendit, pastaj drejtohen të KPF-ja.	Politikë e Financa të cilat caktohen 7 ditë para mbledhjes.
15	Forëmi i kapaciteteve administrative	Parashikimin e një buxheti të veçantë për trajnimin e administratës. Rritja e kapaciteteve për IT-në dhe sigurimin e buxhetit nga donacione për kompensimin e një numri të caktuar të stafit keshillëdhënës për Kryetarin e Komunës dhe Kryesuesin e Kuvendit.	Administrata komunale dhe Kuvendi i Komunës mund të planifikojnë politika për realizimin e kësaj objektivë.	Dokumentet që miratohen nga ekzekutivi dhe legjislativi publikohen në ueb faqe të Komunës.	Njoftimi bëhet me kohë sipas dispozitave ligjore në fuqi.
16	Numeracion dhe platformat e tjera për t'i dhënë qytetarëve informata lidhur me shërbimet që i ofron Komuna.	Numeracioni (03820043716 dhe +38349920517) në Viber dhe WhatsApp) ka për qëllim bashkëpunimin mes qytetarëve të cilëve u jepet e drejta për të paraqitur kërkesë apo ankesë dhe për t'u informuar me shërbimet e Komunës.	Drejtoria e Administratës Komunale dhe Zyra e IT-së dhe Zyra për Komunikim me Publikun	Numeracioni është i vendosur në ueb faqen zyrtare. E-mailat zyrtar dhe numrat e telefonit të drejtorive dhe njësisve të tjera të Komunës janë të publikuara në ueb faqe të Komunës.	Secila kërkesë, apo ankesë e thirrjeve dhe e dërgimit përmes e-mail, do të ketë afatin ligjor në dispozicion për shqyrtimin e saj.



Kryesuesi i Kuvendit
Fadil Gashi

Fadil Gashi